

BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT
DREJTORIA JURIDIKE DHE E PROKURIMEVE

Nr. ____ Prot

Tiranë: ____/____/2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Produktesh Agrokulturore (farëra, fidanë, lule sezonale dhe pleh)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)

- Fara lulesh – 03111900-1
- Fidanë, bulbe, rrënjë dhe prerje - 03121100-6
- Plehra të ndryshme – 24440000-0

Vlera e Fondit Limit është: 15.833.000 (pesëmbëdhjetë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë) lekë pa TVSH.

“Procedurë e hapur”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbeshtetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimeve bazuar në natyrën dhe përmasat e kontratës, specifikimet teknike, grafikonin e lëvrimin të mallit, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia gjykon vendosjen e kriterëve si vijon :

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues,

duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.”

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenin 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 40 pika 3 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë të Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshme dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues i mallrave objekt prokurimi, ai duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara, ku të provohet lidhja me prodhuesin, që vërteton se operatori ekonomik është i autorizuar për tregtimin e mallrave objekt prokurimi.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet e përcaktuara. Ky kriter është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës dhe furnizimin e mallrave sipas grafikut të lëvrimin, deri në ezaurimin e sasive sipas kërkesave të autoriteteve kontraktore përfituese.*

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë / broshurë / skedë teknike për artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog/broshurë/skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas

atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit.

Argumentimi : Kriteri që kërkon paraqitjen e katalogëve ose broshurave zyrtare për mallin e ofruar është vendosur në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, të cilat parashikojnë të drejtën e autoritetit kontraktor për të kërkuar dëshmi të dokumentuara për pajtueshmërinë teknike të produkteve me specifikimet e kontratës.

Ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar:

- që operatori ekonomik ofron një mall konkret me karakteristika të dokumentuara dhe të krahasueshme;

- që modeli i ofertuar përputhet realisht me kërkesat teknike të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së;

- që autoriteti kontraktor të mund të realizojë verifikim transparent dhe objektiv të specifikimeve teknike.

Në mungesë të katalogëve zyrtarë ose broshurave të detajuara, autoriteti kontraktor do të ishte i pamundur të vlerësonte në mënyrë të besueshme përputhshmërinë e artikujve të ofruar me specifikimet e kërkuara, duke rrezikuar furnizimin me mallra jashtë standardit.

Ky kriter nuk kufizon konkurrencën dhe është i arritshëm nga çdo operator që përfaqëson zyrtarisht një prodhues ose ka akses në dokumentacionin teknik të produktit. Broshurat dhe katalogët janë dokumente standarde që çdo prodhues ose distributor i autorizuar i disponon dhe i vë në dispozicion për qëllime tregtare.

Kërkesa për shënimin e qartë të artikujve të ofertuar në katalog siguron gjurmueshmëri dhe shmang pasaktësitë gjatë vlerësimit teknik.

Prandaj, ky kriter është vendosur në mënyrë proporcionale, transparente dhe të arsyetuar, në funksion të përmbushjes me cilësi të objektit të kontratës dhe mbrojtjes së interesit publik.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit” / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuara se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit

të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbeshtetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se OE gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

2.3.6 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar furnizimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 3 (tre) persona të punësuar, në profilet e mëposhtme:

1 (një) “Agronom i lartë”, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

- Diplomë me profesion Agronom i lartë;
- Kontratë pune (e vlefshme);
- CV-në përkatëse

2 (dy) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për ”Punime në fidanishte”, për të të cilët duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- Kontratë pune (e vlefshme) dhe të rezultojnë në listepagesen e shoqërisë.
- Diplomë/certifikata sipas Ligjit Nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin e kërkuar që disponon sipas formatit të mëposhtem:

Tabela 1

| Emer Mbiemer i Punonjësit | Nr Identifikimi (ID/Letërnjoftim) | Profesioni | Institucioni Publik/Privat Lëshues i Certifikatës/Diplomës | Nr NIPT i Institucionit (nëse privat) |
|---------------------------|-----------------------------------|------------|--|---------------------------------------|
| | | | | |

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, si dhe me plotësimin e formatit të deklaratës sipas Tabeles 1

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku përcaktohet “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit e nenit 40, pika 5/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku specifikisht përcaktohet:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si natyra e mallit objekt kontrate që kërkohet të furnizohet. Është marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate i cili do të lëvrohet në mënyrë të vazhdueshme sipas periudhave të mbjelljes ka nevojë ditore për mirëmbajtje dhe shërbime deri në momentin e dorëzimit tek autoriteti

kontraktor dhe gjithashtu fakti që operatori ekonomik do të marrë përsipër furnizimin dhe transportin e mallit ne objektet e percaktuara nga autoriteti kontraktor per mbjellje çka konvergon ne nevojën e që operatori ekonomik fitues potencial i kontratës të disponojë fuqi punëtore për ekzekutimin e objektit të prokurimit me eficence dhe më cilësi. Numri i punonjësve tregon besueshmërinë për autoritetin që, operatori do të përmbushë me sukses kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën 3 punonjës është në përputhje me objektin e kontratës.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kerkesa per **1 (nje) agronom te larte** -, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e drurëve dekorative e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të produkteve të sipërpërmendura duhet të kenë aftësinë teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Agronom i lartë do të supervizojë mbikqyre te gjithë procesin e mirembajtjes dhe të transportit të drurëve dekorative deri ne vendin ku ato do të mbillen me qëllim sigurimin e cilesise te materialit mbjelles bimor deri në momentin e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor. Kriteri sa më sipër është i lidhur ngushtesisht dhe në proporcion me objektin e prokurimit dhe siguron autoritetin kontraktor se operatori ekonomik fitues potencial i procedurës ka stafin e duhur dhe garanton cilësinë e produktit që kerkohet nga autoriteti kontraktor.

Në lidhje me kriterin ku kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, **2(dy) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për " Punime në fidanishte "** është e lidhur ngushtësisht me natyrën dhe artikujt objekt kontrate si dhe me mënyrën e lëvrimin të mallit i cili do të lëvrohet sipas kërkesës së autoritetit kontraktor në periudhat e mbjelljes, mungesa e këtij stafi potencialisht mund të çojë në dështimin e kontratës së furnizimit, ose në rastin më pak të keq do të rezultojë në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe furnizimin e mallit me cilësi të dobët. Numri i stafit në lidhje me këtë kriter është minimal dhe është përcaktuar në raport të ngushtë me natyrën specifike të mallit objekt kontrate.

Kriteret sa më sipër sigurojnë Autoritetin Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik, aftësitë organizative reputacionin dhe besueshmërinë për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt prokurimi. Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40, pika 5/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të kenë të punësuar punonjës të kualifikuar të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit.

2.3.7. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera per mallrat objekt prokurimi te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi:

- a) Çertifikate zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim per nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit, sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certifikate origjinë të lëshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative) ose Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që duhet të jetë i pajisur me Certifikate zyrtare model 3 te aneksi 4, autorizim per nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave te furnizuesit sipas modelit 4 te aneksit 4 dhe certifikate origjine te leshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM vendim Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve te tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative),

ose

Në rastin kur furnizimi do të bëhet nga një prodhues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë operatori ekonomik duhet të paraqesë një autorizim prodhuesi/distributori per furnizimin nga subjekti importues ku duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij, shoqëruar me një deklaratë (nga subjekti importues) qe ne momentin e furnizimit me druret dhe shkurret dekorative (sipas sasise dhe specifikimeve teknike) do shoqerohen me “Çertifikate Fitosanitare” nga shteti importues, e cila verteton pastertine gjenetike bimes.

- b) Për zërin “Humus (Torfë)”, operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë Regjistrimi të produktit plehërues, sipas Ligjit nr. 17/2020, datë 17.02.2020 “Për produktet plehëruese”. Çertifikata duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë në momentin e paraqitjes së ofertës.

Argumentimi: Kriteri sa më sipër është vendosur në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe me nenin 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “dëshmi për rezultatet e testimave zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

Në rastin konkret, kërkohet një dokument certifikues i cilësisë për materialet që autoriteti kontraktor kërkon të blejë. Kërkesa është minimale dhe përputhet me dispozitat e nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, pasi synon të vërtetojë përputhshmërinë e mallrave me kërkesat teknike dhe specifikimet e preventivit. Ky kriter është proporcional me objektin e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi dokumentet janë të siguruara me kosto të ulët dhe të arritshme nga çdo operator i aftë për të përmbushur kontratën.

Ky kriter është vendosur gjithashtu në mbështetje të:

- Ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”;
- Ligjit nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 523, datë 13.07.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit dhe certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese”.

Sipas VKM nr. 523/2016, pika II “Kërkesat për tregtimin e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve”, gërma “d”, përcaktohet se: “Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese mund të tregtohen, nëse: d) janë pajisur me certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi”.

Kriteri synon të garantojë gjurmueshmërinë, cilësinë gjenetike dhe pastërtinë fitosanitare të bimëve, si dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe teknike për mallrat objekt i kontratës.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues, si dhe vendosjen e gomave pranë ambienteve të tij, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoritetet Kontraktore përfituese.

Në përputhje me këto dispozita, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë **dokumentacion plotësues** që dëshmon se operatori ekonomik është në gjendje të realizojë kontratën, duke përfshirë **aspekte logjistike dhe operacionale**, siç është **transporti dhe dorëzimi i mallrave në vendin e përcaktuar**. Ky kriter është **proporcional dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës**, dhe siguron që **furnizimi të realizohet në përputhje me kushtet teknike dhe vendndodhjet e specifikuara nga autoriteti kontraktor**.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Tulipanë (Tulipa spp.) – bulba për mbjellje

- Bulbat e tulipanëve duhet të jenë të varietetit *Tulipa spp.* ose ekuivalent, të cilësisë së parë, të shëndetshëm, të pjekur, të pastër, pa dëmtime mekanike, pa deformime, pa shenja kalbëzimi, myku, tharjeje apo infeksionesh të tjera fitosanitare.
- Bulbat duhet të kenë kalibër minimal **8/10 cm (cirkumferencë)** ose ekuivalent sipas standardit të prodhuesit, dhe të jenë të përshtatshëm për mbjellje në vjeshtë dhe lulëzim në pranverë.
- Ato duhet të garantojnë përqindje mbirjeje/lulëzimi jo më pak se **95%**.
- Furnizimi duhet të realizohet me bulba të ambalazuara dhe të etiketuara qartë sipas varietetit, ngjyrës dhe kalibrit, në mënyrë që të sigurohet identifikimi dhe ruajtja e cilësisë gjatë transportit dhe dorëzimit.

- Ngjyrat duhet të jenë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, si p.sh. e kuqe, e verdhë, lejla ose ngjyra të tjera të ngjashme sipas varietetit të ofertuar.




Foto ilustruese me lloje të ndryshme tulipanësh



Foto ilustruese me bulba tulipanësh të llojeve të ndryshme

2. Ciklaminë (Cyclamen spp.)

- Lulet e llojit **Ciklaminë (Cyclamen spp.)** ose ekuivalent duhet të jenë të kultivuara në vazo, të shëndetshme, të freskëta, me zhvillim normal vegjetativ, pa dëmtime mekanike, pa shenja tharjeje, kalbëzimi, sëmundjesh apo dëmtuesish.
- Bimët duhet të jenë me gjethe të zhvilluara mirë, me ngjyrë karakteristike të llojit dhe me lule ose sythe të formuara.
- Vazoja duhet të ketë diametër jo më të vogël se 14 cm.
- Lulet duhet të paraqiten në ngjyra të ndryshme sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, si p.sh. rozë, e bardhë, e kuqe, lejla ose ngjyra të tjera të ngjashme sipas varietetit të ofertuar.
- Bimët duhet të jenë të rrënjosura mirë në substrat dhe të përshtatshme për mbjellje ose vendosje të menjëhershme në ambiente dekorative.
- Furnizimi duhet të realizohet në kushte të tilla që të garantohet ruajtja e cilësisë së bimës gjatë transportit dhe dorëzimit.



Foto ilustruese e ciklaminës (Cyclamen spp.)

3. Lavandë (Lavandula officinalis)

- Lulet e llojit **Lavandë (Lavandula officinalis)** duhet të jenë të kultivuara në vazo, të shëndetshme, të freskëta, me zhvillim normal vegetativ, pa dëmtime mekanike, pa shenja tharjeje, kalbëzimi, sëmundjesh apo dëmtuesish.
- Bimët duhet të kenë kërcell të formuar mirë, gjethe me ngjyrë dhe formë karakteristike të llojit, si dhe lulëzim normal me ngjyrë karakteristike vjollcë ose të ngjashme sipas varietetit të ofertuar.
- Vazoja duhet të ketë diametër **jo më të vogël se 12 cm**.
- Bimët duhet të jenë të rrënjosura mirë në substrat, me zhvillim të rregullt vegetativ, dhe të përshtatshme për mbjellje ose vendosje të menjëhershme në mjedise dekorative.
- Furnizimi duhet të realizohet në kushte të tilla që të garantohej ruajtja e cilësisë së bimës gjatë transportit dhe dorëzimit.



Foto ilustruese e lavandës (Lavandula officinalis)

4. Viola spp.

- Lulet e llojit **Viola spp.** duhet të furnizohen në vazo dekorative ose në tabaka fidanësh, të jenë të shëndetshme, të freskëta, të zhvilluara mirë, pa dëmtime mekanike, pa shenja tharjeje, kalbëzimi, sëmundjesh apo dëmtuesish.
- Bimët duhet të jenë të rrënjosura mirë në substrat, me zhvillim normal vegetativ, me gjethe dhe lule ose sythe të formuara, të gatshme për mbjellje dhe me efekt dekorativ të menjëhershëm.
- Në rastin e furnizimit në vazo, vazoja duhet të ketë diametër jo më të vogël se 8 cm.
- Ngjyrat duhet të jenë të ndryshme, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Furnizimi duhet të realizohet në kushte që garantojnë ruajtjen e cilësisë së bimës gjatë transportit dhe dorëzimit.



Foto ilustruese e Violës (Viola spp.)

5. Tagetes (Tagetes terrestris)

- Lulet e llojit **Tagetes (Tagetes terrestris)** duhet të furnizohen në vazo, të jenë të shëndetshme, të freskëta, të zhvilluara mirë, pa dëmtime mekanike, pa shenja tharjeje, kalbëzimi, sëmundjesh apo dëmtuesish.
- Bimët duhet të jenë të rrënjosura mirë në substrat, me zhvillim normal vegetativ, me gjethe dhe lule ose sythe të formuara, të gatshme për mbjellje dhe me efekt dekorativ të menjëhershëm. Vazoja duhet të ketë diametër jo më të vogël se 8 cm.
- Ngjyra e luleve duhet të jetë e verdhë, portokalli ose nuanca të ngjashme sipas varietetit të ofertuar.
- Furnizimi duhet të realizohet në kushte që garantojnë ruajtjen e cilësisë së bimës gjatë transportit dhe dorëzimit.



Foto ilustruese e Tagetes (Tagetes terrestris)

6. Agapanthus

- Lulet e llojit **Agapanthus** duhet të furnizohen **në vazo**, të jenë të shëndetshme, të freskëta, të zhvilluara mirë, pa dëmtime mekanike, pa shenja tharjeje, kalbëzimi, sëmundjesh apo dëmtuesish.
- Bimët duhet të jenë të rrënjosura mirë në substrat, me zhvillim normal vegetativ, me gjethe të formuara mirë dhe me lule ose sythe të formuara, të gatshme për mbjellje ose vendosje të menjëhershme në ambiente dekorative.
- Vazoja duhet të ketë diametër jo më të vogël se 17 cm.
- Furnizimi duhet të realizohet në kushte që garantojnë ruajtjen e cilësisë së bimës gjatë transportit dhe dorëzimit.



Foto ilustruese e Agapanthus

7. Trëndafil kacavjerrës (Rosa spp.)

- Trëndafili kacavjerrës është bimë dekorative shumëvjeçare, i cili duhet të furnizohet në vazo, të jetë i shëndetshëm, i freskët, i zhvilluar mirë, pa dëmtime mekanike, pa shenja tharjeje, kalbëzimi, sëmundjesh apo dëmtuesish.
- Bima duhet të ketë cikël jetese shumëvjeçar dhe të jetë e përshtatshme për mbjellje të qëndrueshme në parqe, lulishte dhe ambiente të tjera dekorative.
- Bima duhet të jetë e rrënjosur mirë në substrat, me zhvillim normal vegetativ, me degë të formuara mirë dhe me lule ose sythe të formuara, e gatshme për mbjellje ose vendosje të menjëhershme në ambiente dekorative.
- Vazoja duhet të ketë diametër jo më të vogël se 17 cm.
- Furnizimi duhet të realizohet në kushte që garantojnë ruajtjen e cilësisë së bimës gjatë transportit dhe dorëzimit.



Foto ilustruese e trëndafilit kacavjerrës (Rosa spp.)

8. Loropetalum (Loropetalum chinense)

- Loropetalum (Loropetalum chinense) është bimë dekorative shumëvjeçare, e cila duhet të furnizohet në vazo, të jetë e shëndetshme, e freskët, e zhvilluar mirë, pa dëmtime mekanike, pa shenja tharjeje, kalbëzimi, sëmundjesh apo dëmtuesish.
- Ajo duhet të jetë e rrënjosur mirë në substrat, me zhvillim normal vegetativ, me gjethe karakteristike të llojit dhe me lule ose sythe të formuara.
- Vazoja duhet të ketë diametër jo më të vogël se 16 cm.

- Furnizimi duhet të realizohet në kushte që garantojnë ruajtjen e cilësisë së bimës gjatë transportit dhe dorëzimit.



Foto ilustruese e Loropetalum (Loropetalum chinense)

9. Fara të ndryshme lulesh (si Begonia, Viola, Tagetes, Petunia, Lule zjarri etj.)

- Farat duhet të jenë të përshtatshme për mbjellje sipas sezonit dhe natyrës së secilit lloj luleje, për përdorim në stinë të ndryshme të vitit.
- Farat duhet të jenë të pastra, me pastërti të lartë, pa përzierje me fara të tjera, pa papastërti dhe pa materiale të huaja.
- Farat duhet të jenë të shëndetshme, pa dëmtime mekanike, pa shenja lagështie, myku, kalbëzimi, sëmundjesh apo dëmtuesish.
- Farat duhet të kenë përqindje mbirjeje jo më të ulët se 70%.
- Farat duhet të jenë uniforme dhe të përputhen me llojin e deklaruar në ambalazh.
- Farat duhet të furnizohen në ambalazh të mbyllur, të pastër, të padëmtuar dhe të përshtatshëm për ruajtjen e cilësisë së farës.
- Pesha neto e ambalazhit duhet të jetë jo më e vogël se 50 gr për paketim.
- Në etiketën e ambalazhit duhet të pasqyrohen qartë të paktën këto të dhëna:
 - emri i bimës;
 - varieteti, kur është i aplikueshëm;
 - numri i partisë/lotit;
 - data e prodhimit ose paketimit;
 - afati i përdorimit;
 - pesha neto e paketimit në gram.
- Farat duhet të jenë të përshtatshme për rritje në sera dhe për mbjellje të mëvonshme në natyrë, sipas karakteristikave të llojit përkatës.

10. Farë bari

- Fara e barit duhet të jetë e përshtatshme për mbjellje të drejtpërdrejtë në natyrë, në parqe, lulishte dhe sipërfaqe të tjera të gjelbëruara.
- Fara duhet të jetë e pastër, e shëndetshme, pa papastërti, pa përzierje të padëshiruara, pa shenja lagështie, myku, kalbëzimi, sëmundjesh apo dëmtuesish.

- Fara duhet të ketë përqindje mbirjeje jo më të ulët se 70%.
- Fara duhet të furnizohet në ambalazh të mbyllur, të pastër, të padëmtuar dhe të përshtatshëm për ruajtjen e cilësisë së produktit.
- Paketimi duhet të jetë 1 kg ose 10 kg, me peshë neto të deklaruar qartë në etiketë.
- Në etiketën e ambalazhit duhet të pasqyrohen qartë emërtimi i produktit, përbërja, numri i partisë/lotit, data e prodhimit ose paketimit, afati i përdorimit dhe pesha neto.
- Përbërja e farës së barit duhet të jetë si më poshtë:
 - ✓ Festuca Arundinacea Troubadix – 60%
 - ✓ Lolium Perenne Romeo – 25%
 - ✓ Poa Pratensis Evora – 10%
 - ✓ Festuca Rubra Maxima – 5%
- Fara duhet të jetë e përshtatshme për krijimin e sipërfaqeve të gjelbra dekorative dhe funksionale, me qëndrueshmëri të mirë për përdorim në parqe dhe ambiente të tjera të gjelbëruara.

11. Pleh organik i thatë

- Plehu organik duhet të jetë i thatë, i dekompozuar plotësisht dhe i përshtatshëm për përdorim në toka bujqësore, sipërfaqe të gjelbëruara, parqe dhe lulishte.
- Plehu organik duhet të jetë homogjen, pa papastërti, pa mbetje të huaja, pa gurë, plastikë ose materiale të tjera të padëshiruara.
- Produkti duhet të jetë pa erë të rëndë kalbëzimi, pa shenja myku, lagështie të tepërt ose prishjeje.
- Plehu organik duhet të jetë i sigurt për përdorim, i stabilizuar dhe pa elementë që mund të dëmtojnë bimët ose cilësinë e tokës.
- Ambalazhimi duhet të jetë në thasë të mbyllur, të pastër, të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm për ruajtjen dhe transportin e produktit.
- Pesha e çdo thesi duhet të jetë jo më e madhe se 20 kg.
- Në ambalazh duhet të pasqyrohen qartë emërtimi i produktit, pesha neto, prodhuesi ose distributori, data e prodhimit ose paketimit, si dhe të dhëna të tjera identifikuese sipas rastit.

12. Torfë organike për lule

- Torfa organike duhet të jetë e përshtatshme për përdorim në lule dhe bimë dekorative, e pasur me lëndë ushqyese dhe elementë fertilizues, me qëllim mbështetjen e rritjes dhe lulëzimit të bimëve.
- Produkti duhet të jetë homogjen, i pastër, pa papastërti, pa mbetje të huaja dhe i përshtatshëm për përdorim në substrat për lule.
- Gjendja fizike dhe ngjyra duhet të jetë torfë e zezë e përzier me torfë të bardhë.
- Baza e produktit duhet të përmbajë torfë (H2–H8), pleh gëlqeror, argjilë, perlit dhe NPK.
- Përmbajtja ushqyese duhet të jetë si më poshtë:

- Azot total (N): 300 mg/l
 - Pentaoksid fosfori (P₂O₅): 300 mg/l
 - Oksid kaliumi (K₂O): 300 mg/l
 - Magnez (Mg): 180 mg/l
 - Squfur (S): 160 mg/l
- Produkti duhet të jetë i përshtatshëm për përdorim në mbjellje dhe kultivim lulesh, duke siguruar ajrosje, mbajtje të lagështisë dhe ushqyesit e nevojshëm për zhvillimin e bimës.
 - Ambalazhimi duhet të jetë i mbyllur, i pastër, i padëmtuar dhe i përshtatshëm për ruajtjen e cilësisë së produktit.
 - Ambalazhi duhet të jetë me vëllim nga 70 deri në 80 litra.
 - Në etiketën e ambalazhit duhet të pasqyrohen qartë emërtimi i produktit, përbërja, karakteristikat kryesore, vëllimi, prodhuesi ose distributori, si dhe të dhëna të tjera identifikuese sipas rastit.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Argumentimi i specifikimeve

Përzgjedhja e materialeve bimore dhe produkteve ndihmëse objekt prokurimi është bërë në funksion të nevojave për gjelbërim dekorativ, përmirësim estetik dhe mirëmbajtje të qëndrueshme të hapësirave publike në administrim të Bashkisë Tiranë. Specifikimet teknike janë hartuar duke pasur parasysh kushtet klimatike të zonës, ciklin sezonal të zhvillimit të bimëve, përshtatshmërinë e tyre për mjedisin urban, si dhe nevojën për të siguruar lulëzim, gjelbërim dhe efekt dekorativ gjatë periudhave të ndryshme të vitit.

***Tulipanët** janë përzgjedhur si bimë bulbore tipike për mbjellje vjeshtore dhe lulëzim pranveror, me vlerë të lartë dekorative. Ciklaminat dhe violat janë bimë të përshtatshme për periudhën dimër–pranverë, për shkak të rezistencës ndaj temperaturave më të ulëta dhe aftësisë për të siguruar ngjyrë dhe efekt dekorativ edhe në periudha me aktivitet të kufizuar vegjetativ. Tagetes është përzgjedhur si lule sezonale për periudhën pranverë–verë, për shkak të përshtatshmërisë së mirë në sipërfaqe dekorative dhe të efektit estetik të menjëhershëm.*

***Lavanda, Agapanthus, trëndafili kacavjerrës dhe Loropetalum** janë zgjedhur si bimë dekorative shumëvjeçare, të përshtatshme për kushte urbane, me qëndrueshmëri të lartë, vlerë estetike dhe përdorim afatgjatë në parqe, lulishte dhe mjedise të tjera të gjelbëruara. Këto bimë sigurojnë strukturë dekorative, gjelbërim të qëndrueshëm dhe alternim lulëzimi sipas sezonit.*

***Farat e ndryshme të luleve** janë parashikuar për mbjellje sezonale dhe për prodhimin e materialit dekorativ sipas nevojave të periudhave të ndryshme të vitit. Fara e barit është përcaktuar për*

krijimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra dekorative dhe funksionale, me përshtatshmëri për mbjellje të drejtpërdrejtë në natyrë dhe për përdorim në hapësira publike.

Plehu organik i thatë dhe torfa organike për lule janë përfshirë si produkte të domosdoshme ndihmëse për përmirësimin e cilësisë së tokës, rritjen e përmbajtjes organike, ruajtjen e lagështisë, ajrosjen e substratit dhe mbështetjen e zhvillimit të shëndetshëm të sistemit rrënjor dhe të vetë bimëve.

Në tërësi, kombinimi i këtyre materialeve siguron vazhdimësi dekorative sipas stinëve, përshtatshmëri klimatike dhe urbane, si dhe krijimin e hapësirave publike me funksion estetik dhe peizazhistik.

Specifikimet teknike janë përcaktuar për të garantuar cilësi, qëndrueshmëri, funksionalitet dhe përshtatshmëri të mallrave objekt prokurimi me qëllimin e realizimit me sukses të gjelbërimit dekorativ në mjediset publike të Bashkisë Tiranë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Afati i lëvrimin deri më 15.12.2026 është përcaktuar si afat i arsyeshëm dhe teknikisht i nevojshëm, duke pasur parasysh natyrën sezonale të artikujve objekt prokurimi, ciklin biologjik të bimëve dhe periudhat optimale të mbjelljes së tyre. Ky afat i shërben realizimit në kohë të proceseve të gjelbërimit, shmangies së vonësive që mund të cenojnë mbjelljen dhe efektin dekorativ të materialeve bimore, si dhe garanton planifikim të rregullt, konkurrencë të barabartë dhe përmbushje të nevojave operationale të institucionit.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, bazuar në nevojat e autoritetit kontraktor përfitues.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT